



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KABINETI

**NJOFTIM PËR SHTYP**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërisë Euroconsult Rental Division S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni mbi përfitim të kontrollit të shoqërisë Euroconsult Rental Division S.p.A nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.

Palët pjesëmarrëse:

*Pala blerëse:* Intesa Sanpaolo S.p.A, (ISP) është një shoqëri aksionare e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit Italian. ISP ka objekt kryesor ofrimin e: transaksioneve bankare, investimeve bankare, financë të strukturuar, tregje kapitali etj.

Intesa Sanpaolo S.p.A (*ISP*) është shoqëria mëmë e Grupit Intesa Sanpaolo Group (*ISP*), e cila është e pranishme në Shqipëri përmes filialit të zotëruar plotësisht prej saj Intesa Sanpaolo Bank Albania, SHA.

*Pala shitëse:*

- Euroconsult 2001 Srl (EC 2001) është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Italian, me seli në Milano, zotëruese e 75% të kapitalit të shoqërisë target.
- Locatec Sas di Francesco Miscioscia & C (Locatec) është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Italian, me seli në Cinisello Balsamo (MI) zotëruese e 25% të kapitalit të shoqërisë target.

*Shoqëri Target:* Euroconsult Rental Division S.p.A (ERD) është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit italian, me objektet veprimtarie: blerjen, shitjen, komercializimin, marrjen e mandateve dhe përfaqësive dhe dhënie me qira të mallrave dhe pajisjeve (me përjashtim të automjeteve), për individë privatë, ndërmarrje, shoqëri, institucione krediti etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**